

FORMULARI NUMËR 4

KONCEPT DOKUMENTI PËR KRYEPROKUROR

Mbiemri:	GASHI
Emri:	VALDET

Bazuar në kompetencat ligjore të parapara për pozitën që aplikoni, ju lutem të ofroni:

I. Analizën tuaj, si vijon:

1. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë e Shtetit?

Gjendja në Prokurorin e Shtetit është me zhvillime sfiduese në disa drejtime. E përcjellë me ndryshime të shumta ligjore, me sisteme ndërkomëtare e vendore të administrimit që nga viti 2000, sot prokuroria e ka të vendosur vendimmarrjen dhe politikbërjen në dy trupa të ndryshëm të cilëve u duhet koordinim dhe kualitet të vendimmarrjes. Trupi i parë i administrimit, ai i Këshillit Prokurorial të Kosovës është duke u përballuar me një sërë sfidash dhe i duhet mbështetje më e madhe për të siguruar resurset e duhura për Prokurorin e Shtetit, ndërsa trupi i dytë ai i vet Prokurorit të Shtetit i cili për të operuar me kapacitete të plota i duhet siguri më e madhe në realizim të funksionit kushtetues e ligjor, përfshirë kapacitetet adekuate nga aspekti i integritetit të prokurorëve dhe stafit. Të dy këto trupa bashkërisht mund t'i tejkalojnë sfidat dhe të garantojnë siguri juridike, të tregojnë llogaridhënie dhe me profesionalizëm ta sigurojnë besimin e publikut. Aktualisht ka kritika të vazhdueshme në punën e prokurorisë dhe kuptohet nganjëherë edhe me të drejtë, por ngritja e sistemit prokurorial mund të vihet në jetë vetëm me ngritjen e kapaciteteve njerëzore duke filluar nga ato të udhëheqjes. Këto kapacitete do të mundësojnë politika adekuate, llogaridhënie më të plotë dhe rol proaktiv në mbrojtje të vlerave të të gjithëve pa dallim në vendin tonë.

2. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë që keni aplikuar?

Prokuroria ku kam aplikuar mund të karakterizohet si një ndër institucionet më proaktive në zbatimin e mandatit të vet ligjor. PSRK aktualisht është e strukturuar mirë, ka numër pothuajse të mjaftueshëm të prokurorëve dhe personelit administrativ si dhe kohëve të fundit janë përmirësuar shumë edhe kushtet e punës (pas vendosjes në zyre të një objekti të renovuar).

Sa i përket numrit të lëndëve dua të theksoj se krahas punës për zgjidhjen e rasteve të grumbulluara ndër vite, PSRK është shumë proaktive në hetimin dhe procedimin e rasteve të natyrës korruptive, krimit të organizuar, shpërlarjes së parave, kimeve të luftës etj, ku si të pandehur në rastet korruptive janë përfshirë edhe zyrtarë të niveleve të larta shtetërore. Gjithashtu ka vazduar ngritja e kapaciteteve të prokurorëve dhe stafit administrativ gjë e cila mundeson avancimin e proceseve të punës dhe suksesit të PSRK-së e njëkohësisht edhe rritjen e besimit të publikut.

3. Cilat janë mangësitë dhe sfidat kryesore të kësaj prokurorie?

Mangësitë e PSRK-së nuk janë të vërejtshme duke marrë parasysh proceset nëpër të cilat ka kaluar ky institucion. Mangësitë kryesore deri më tanë kishin të bëjnë me numrin e pamjaftueshëm të prokurorëve dhe stafit profesional administrativ si dhe shkëputja në trajtim adekuat financiar e stafit administrativ krahuar me prokurorët. Përderisa ky numër tanë është rritur, një sfidë reale mbetet trajnimi dhe ngritja e vazhdueshme profesionale sidomos në aspektin e planifikimit për hetim më efektiv të rasteve si dhe arritjen e një suksesi më të lartë në përfaqësimin e tyre në gjykatë. Përfundimisht vetëm prokurorët dhe stafi adekuat mund ta mbajnë në jetë një prokurori speciale me integritet, efektive dhe që gjëzon besimin e publikut.

Edhe përkundër faktit se është krijuar një konsolidim i mirë i prokurorëve, stafit mbështetës dhe institucioneve tjera, hetimet e kimeve të luftës mbesin ende sfiduese për shkak të faktorëve tjerë e qe në fakt nuk janë në mundësit e PSRK-së t'i ndryshoj. Gjithashtu sfidë mbetet suksesi në sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar me vepra penale. Përveç mangësive e sfidave të lartpërmendura, një mangësi e cila ka nevojë të trajtohet seriozisht mbetet bashkëpunimi ndërinstitucional, sidomos bashkëpunimi me policinë dhe organet tjera shtetërore të cilat paraqesin kallëzime penale dhe që aktivisht kanë rol kyç në luftimin e kriminalitetit.

PSRK është shoqëruar edhe me sfida të shumta e të cilat kanë ndikuar në kualitetin e performacës së tij. Ndryshimet e shumta ligjore, strategjitetë shtetërore ku roli i PSRK-së nuk ishte i definuar mirë si dhe koordinimi i pamjaftueshëm i pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ me sistemin prokurorial ishin sfidat kryesore qe në vete mbartën edhe rreziqe. Pa dyshim mungesa e ekspertizës vendore dhe ofrimi i llojlojshmërisë së ekspertizës ndërkombëtare ka krijuar sfidën e marrjes së përvojave adekuate të përshtatshme e nganjëherë edhe jo adekuate me mundësi të papërshtatjesh totale. Përkundër mbështetjes së shumë partnerëve ndërkombëtarë sidomos në procesin e ngritjes së kapaciteteve të prokurorëve sfidë e madhe ishte koordinimi i tyre dhe bërja vend e projekteve nganjëherë me objektiva të ngjashme. Aplikimi i SMIL po ashtu është ndër sfidat kryesore, ndërsa përvojat dhe puna e përbashkët ekipore ndërmjet prokurorëve dhe stafit krijojnë mundësi më të mira për realizim të mandatit të kësaj prokurorie.

4. A mendoni se strategjitet aktuale te sistemit adresojnë nevojat e Prokurorisë për të cilën aplikoni si Kryeprokuror?

Ka afërsisht një dekadë që KPK dhe Prokurori i Shtetit kanë punuar në avancimin e planifikimit të proceseve të punës. Janë hartuar plane strategjike dhe plane pune të cilat deri diku i kanë adresuar nevojat e PSRK-së. Megjithatë ka segmente dhe nevoja të cilat do të ishte mirë që të adresohen edhe më mire në strategjitet e KPK-së dhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit në bashkëpunim të ngushtë me PSRK-në. Puna e PSRK-së do të ishte më efektive dhe më e besueshme për publikun sikur strategjitet e sistemit prokurorial të adresojnë disa çështje më me vëmendje dhe nga këndvështrimi më pozitiv i mediave, shoqërisë civile, forumeve të ndryshme vendore dhe ndërkontaktare. Mbetet për të punuar me aktorë të ndryshëm në adresimin koherent dhe adekuat të nevojave specifike të PSRK-së.

II. Vizioni juaj në përmirësimin e punës operative në Prokurorinë që keni aplikuar?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet e juaj afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjate:

1. Cili është vizioni juaj për të përmirësuar punën operative gjatë mandatit tuaj?

Një PSRK me integritet personal dhe profesional e cila gjëzon besimin e publikut duke vepruar me efikasitet, e pavarur, e paanshme, llogaridhënëse dhe transparente është vizioni im.

2. Cilat janë objektivat tuaja kryesore?

Zbatimi me kompetencë i mandatit të përcaktuar ligjor me fokus në hetimin profesional dhe ndjekjen e kryesve të veprave penale dhe mbrojtjen e viktimate të krimít dhe të dëmtuarve do të jenë pjesë e objektivave të mia si Kryeprokuror i PSRK-së. Si Kryeprokuror i PSRK-së jam i përkushtuar që përgjatë mandatit tim t'i realizojë objektivat si:

a). Hetim profesional, të pavarur dhe objektiv nga prokurorët e PSRK-së

Që PSRK të ketë integritet dhe të gjëzojë besimin e publikut duhet që veprimet e prokurorëve të jenë profesionale, të pavarura dhe objektive. Për tu arritur kjo si Kryeprokuror i PSRK-së do të angazhohem që të avancohet sistemi aktual i punës, të shtohet mbikëqyrja, profesionalizmi dhe llogaridhënia e prokurorëve. Po ashtu do të punoj ngushtë me KPK-në që vlerësimi i përformancës së prokurorëve të mbështetet në merita dhe efekte të punës së tyre, përfshirë veprimtarinë dhe sjelljen me integritet të lartë. Një vëmendje e theksuar do t'i kushtohet trajnimeve të specializuara për prokurorë dhe hartim të manualeve dhe udhëzuesve të cilët lehtësojnë punën e

prokurorëve. Vlerësimi dhe zbatimi i rekomandimeve të organizatave vendore dhe ndërkontaktare do të ketë një vend të merituar dhe do të përdoret për të ngritur efektivitetin e punës së prokurorëve dhe PSRK-së në përgjithësi.

b). Forcim i sistemit të mbikëqyrjes dhe llogaridhënieve në PSRK

Në mënyrë që të ketë një mbikëqyrje dhe llogaridhënie adekuate të PSRK-së është domosdoshmëri që të avancohet tutje mbikëqyrja e punës së prokurorëve dhe stafit. Në këtë kuptim do të rishikohet sistemi aktual i komunikimit me udhëheqës të departamenteve dhe prokurorë në PSRK. Për qëllime të zbatimit të kësaj objektive do të vendoset një sistem për planifikim të hetimeve dhe përgatitje të lëndëve bazuar në ligj dhe prova konkrete. Dhënia e udhëzimeve dhe mbikëqyrja e rezultateve të punës së prokurorëve do të jetë në fokus të vazhdueshëm për mua si kryeprokuror i PSRK-së.

c). Rol proaktiv për hetim dhe ndjekje cilësore

Në realizim të mandatit ligjor prokurorët e PSRK-së duhet të ndërmarrin veprimet e tyre me proaktivitet dhe duke aplikuar standarde të larta të profesionalizmit. Si Kryeprokuror i PSRK-së do të ndërmarr të gjitha veprimet ligjore që hetimi dhe ndjekja e kryesve të veprave penale, përfshirë sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së fituar përmes veprave penale të bëhet në mënyrë efikase, efektive për të gjithë kryesit e veprave penale pa dallim. Realizimin e kësaj objektive synoj të bëjë përmes forcimit të bashkëpunimit me institucione të zbatimit të ligjit, formimit të task-forcave të përbashkëta për hetime brenda e jashtë vendit, organizim të trajnimeve të specializuara për prokurorët dhe aplikim të udhëzimeve të shkruara për prokurorë.

ç). Avancimi i pozitës së prokurorëve dhe stafit

Jo vetëm si pjesë e reformës në drejtësi, por edhe si pjesë e dokumenteve strategjike dhe planeve të punës së PSRK-së do të jetë hartimi i propozimeve ligjore të cilat e avancojnë më tutje pozitën e prokurorëve dhe stafit. Pika kësia im do të jetë mirëqenia e prokurorëve dhe stafit sepse vetëm në këtë mënyrë mund të garantojmë një sistem i cili respekton të drejtat dhe liritë e njeriut me fokus në viktimat e krimít. Në këtë drejtim do të punohet ngushtë me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe KPK-në në hartim të legjisacionit i cili e avancon më tutje statusin e prokurorëve dhe stafit.

e). Zbatim i plotë i sistemit elektronik për menaxhimin e rasteve - SMIL

Objektiviteti, paanshmëria, transparenca janë faktorë kyç në besimin e publikut për punën e PSRK-së. Me qëllim të arritjes së këtij synimi mbështetje të padiskutueshme

është avancimi dhe zbatimi i plotë i data bazave aktuale, krijimi i atyre të reja si dhe aplikimi i Sistemit Elektronik për Menagjimin e Rasteve (SMIL) në PSRK. Aplikimi i SMIL mundëson efektivitet të shërbimeve të prokurorisë, llogaridhënie, transparencë, respektim të të drejtave të njeriut dhe besim më të madh të publikut.

f). Avancim i shërbimeve në mbrojtje të viktimate të krimit, të dëmtuarve dhe dëshmitarëve

Si Kryeprokuror i PSRK-së do ta kem si prioritet edhe ngritjen e nivelit për mbrojtjen e viktimate të krimit, të dëmtuarve dhe dëshmitarëve. Në fund të fundit roli dhe funksioni i prokurorit mund të realizohet vetëm duke e arritur mbrojtjen e pakusht të këtyre kategorive, respektivisht e kundërtat do të thoshte jo vetëm paaftësi për edhe papërgjegjësi për prokurorinë. Në këtë drejtim do të mundësojë ngritje të kapaciteteve, hartim të politikave dhe dokumenteve të cilat mundësojnë qasje profesionale, bashkëpunim me institucionet përgjegjëse dhe sigurim të mbrojtjes adekuate për kategoritë e lartpërmendura.

3. Cilat janë vështirësítë apo rreziqet që prisni gjatë përbushjes së këtyre objektivave?

Gjatë realizimit të objektivave të përcaktuara pres që të hasë në sfida të ndryshme disa nga të cilat do t'i rendis si në vijim:

- Zbatimi i reformës në drejtësi e cila përfshinë ndryshimet ligjore eventuale;
- Ndryshimet e legjislacionit penal me efekt eventual në politikat eventuale të miratuara më parë;
- Mosmiratimi i kërkesave buxhetore sipas nevojave të PSRK-së;
- Fuqizimi i integritetit të prokurorëve dhe stafit;
- Zbatimi i Sistemit për Menaxhimin Elektronik të Lëndëve - SMIL;
- Zgjidhja e lëndëve të vjetra;
- Rritja e cilësisë së ekspertizave për rastet e prokurorëve;
- Efikasiteti më i lartë në trajtimin e rasteve të korruptionit dhe krimit të organizuar përfshirë vlerën e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar;
- Ngritja e kualitetit të vendimeve të prokurorëve lidhur me hetimet dhe aktakuzat;
- Ngritja e vazhdueshme profesionale e prokurorëve dhe stafit;
- Profilizimi dhe specializimi i prokurorëve për fusha specifike;
- Ngritja e bashkëpunimit dhe ndërveprimit me institucione të zbatimit të ligjit;

4. Si do t'i tejkalonit ato?

Sfidat e sipër theksuara do të tejkalohen vetëm me një përkushtim ekipor, një planifikim adekuat dhe resurse të mjaftueshme. Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe partnerët ndërkombëtarë sidomos atyre që ofrojnë ekspertizë dhe projekte përmbajtësore është qelës i shumicës së zgjidhjeve për tejkalim të sfidave.

Fokusi kryesor do të jetë puna me ekipe të ndryshme të ekspertëve vendorë e ndërkombëtarë, hartimi i planeve adekuate dhe projekteve të cilat ofrojnë zgjidhje të synuara me objektivat e caktuara qoftë nga unë si Kryeprokuror i PSRK-së qoftë nga ana e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës. Si Kryeprokuror i PSRK-së do të luaj rol prijës në proceset e reformave në drejtësi, hartimin e koncept dokumenteve për ndryshimet eventuale ligjore, hartimin e kërkesave buxhetore adekuate, hartimin e strategjive, akteve dhe politikave përkatëse, përfshirë themelin e mekanizmave adekuat që në sistemin prokurorial të ketë vetëm prokurorë me integritet personal dhe profesional.

III. Vizioni juaj për të avancuar administratën në Prokurorinë që keni aplikuar;

Ju lutem renditni hapat konkret që do t'i ndërmerrnit gjatë mandatit tuaj:

1. Cilat janë metodat dhe mënyrat tuaja për avancimin e stafit administrativ?

Duke marr për bazë faktin që stafi i PSRK-së kanë status tjetër nga ai i prokurorëve, por puna e tyre lidhet drejtpërdrejtë me përformancën e prokurorëve, menaxhimi i tyre kërkon një qasje gjithëpërfshirëse. Në radhë të parë, do të punoj që stafi administrativ i PSRK-së të ketë integritet të lartë profesional dhe personal, të ketë trajtimin adekuat financiar dhe kushte sa më të mira të punës. Krahas kësaj do të angazhohem pareshtur që të promovohet sistemi i rekrutimit, avancimit dhe vlerësimit në bazë të meritës, ndërsa disiplina dhe kualiteti i punës do tëjenë faktorët kyç që dikush të mbajë pozitën e stafit administrativ në PSRK.

Mbështetja ime do të drejtohet edhe në ngritjen e kapaciteteve të stafit përmes trajnimeve dhe ndërtimi i sistemit të karrierës përmes vlerësimit objektiv e në bazë të rezultateve në punë. Një segment të cilin do ta promovojë në raport me menagjimin e stafit është udhëzimi i administratorit dhe prokurorëve që në proceset e punës të ketë aplikim të standardeve të larta, respektim të konfidencialitetit dhe efikasitet në kryerje të detyrave të punës.

2. Si planifikoni ndarjen e barabartë të punës për stafin administrativ?

Së bashku me udhëheqësit e departamenteve dhe administratorin e PSRK-së do të bëjmë analizimin e ngarkesës me punë të stafit. Ndarja e punës së stafit do të bëhet në mënyrë të barabartë bazuar në përshkrimin e detyrave të punës, kualifikimin e stafit, trajnimet e tyre si dhe nevojat dhe kërkesat e prokurorëve në varësi të lëndëve

që trajtojnë. Vendorsja e standardeve unike për punë, respektimi i nivelit të kërkuar të profesionalizmit dhe përformancës do të jenë prioritete kyçë në ndarjen e barabartë të punës për stafin.

3. Si planifikoni të përmirësoni llogaridhënien dhe profesionalizmin e stafit administrativ?

Krijimi i një sistemi unik të raportimit dhe mbikëqyrjes permanente, vlerësimi i përformancës bazuar në kritere të qarta dhe objektive do të janë pikënisje për të përmirësuar llogaridhënien e stafit. Në anën tjetër trajnimi dhe udhëzimet adekuate e të bazuara në nevoja konkrete janë rruga e cila do të ndiqet për të ngritur profesionalizmin në punë. Gjithashtu do të punohet në atë drejtim që proceset e punës të menagjohen përmes sistemeve elektronike dhe databazave të përshtatshme. Do të propozohet dhe avancohet dhe promovohet mënyra proaktive dhe ekipore e punës, përfshirë publikimin e punës dhe rezultateve për prokurorë dhe për stafit administrativ. Mbikëqyrja e stafit do të bëhet duke i motivuar ata për arritjen e rezultateve të mira dhe për punën e bërë duke respektuar vlerat e mbrojtura nga kushtetuta dhe ligji. Në anën tjetër do të reagohet gjithmonë ndaj shkeljeve disiplinore dhe do të ndërmerren masa ligjore adekuate për ata që i kryejnë ato shkelje.

IV. Hapat që do të ndërmerrni në përmirësimin e integritetit dhe llogaridhënieς në Prokurorinë që keni aplikuar dhe besimin e publikut?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet e juaj afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjate:

1. Përvoja e juaj e deri tanishme?

Duke qenë zëvendës kryeprokuror i PSRK-së kam pasur rastin që të marr pjesë në grupe të ndryshme punuese ku janë hartuar dokumente strategjike dhe plane pune për të përmirësuar përformancën e PSRK-së, por edhe në grupe punuese ku janë hartuar koncept dokumente dhe draft ligje të cilat synojnë reformimin e sistemit të drejtësisë në përgjithësi dhe atij prokurorial në veçanti. Angazhimi im do të jetë edhe më proaktiv që çdo plan dhe strategji e Prokurorit të Shtetit dhe KPK-së të përfshijë avancimin e pozitës së PSRK-së.

2. Hapat që do të ndërmerrni për të ngritur nivelin e besueshmërisë në Prokurorinë tuaj duke vënë baraspeshë mes transparencës dhe konfidentialitetit të procedurës?

Në cilësi të Kryeprokurorit të PSRK-së do të mbështes të gjitha proceset e digjitalizimit të punës, sidomos do të jem i vendorsur në përdorimin e SMIL, ngritjen e kapaciteteve të prokurorëve dhe stafit për të qenë më transparent dhe të kenë integritet si bartës të këtyre funksioneve. Do të bëjë të mundur hartimin e politikave

për të ngritur besimin e publikut dhe do të mbikëqyrë drejtpërdrejtë zbatimin e tyre. Pjesë kryesore e këtyre politikave do të jetë hartimi dhe aplikimi i strategjive standard të komunikimit me media dhe publikun, komunikimi me të dëmtuarit dhe viktimat e krimít, por edhe të pandehurit. Në bashkëpunim me KPK dhe Akademinë e Drejtësisë do të punoj ngushtë që për prokurorët dhe stafin e PSRK-së të zbatohen programe trajnuese specifike dhe të specializuara në përmirësim të transparencës dhe llogaridhënie. Në anën tjetër do të shtoj mbikëqyrjen e aplikimit të ligjit dhe standardeve në çdo rast duke respektuar konfidencialitetin e procedurës, të drejtat dhe liritë e njeriut dhe ngritur besimin e publikut.

3. Çfarë planifikoni të ndërmerrni për të siguruar punë cilësore në Prokurorinë tuaj?


Do të punojë ngushtë me prokurorët dhe stafin e PSRK-së që çdo proces i punës dhe vendimmarrje rreth lënëve të planifikohet paraprakisht, të ndërmerrret sipas standardeve më të larta të profesionalizmit dhe etikës. Mbikëqyrja dhe udhëzimet proaktive dhe të vazhdueshme do të aplikohen nga unë përmes protokolleve, raportimeve dhe punës ekipoje të aplikuar si pjesë e përditshme e punës. Së bashku me prokurorët dhe stafin e PSRK-së do të propozojmë dhe mbajmë trajnime konkrete në Akademinë e Drejtësisë dhe me partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë me qëllim përmirësimin e shkathtësive praktike. Përmes komisioneve respektive te KPK-së do të realizoj vlerësimin meritor të përformancës të prokurorëve dhe stafit dhe zhvillimi i tyre në karrierë do të varet nga ky vlerësim.

4. Çfarë planifikoni të përmirësoni në llogaridhëni e përgjithshme në Prokurorinë tuaj?

Do të punoj në avancimin e një sistemi proaktiv të punës, përmirësimin e proceseve digjitalizuese të punëve, aplikimin e padiskutueshëm të SMIL, vlerësimin e rezultateve dhe suksesit të aktakuzave në gjykatë, zbatimin e rekomandimeve të raporteve relevante vendore e ndërkombëtare për punë e PSRK-së. Në këtë drejtim do të mbështes pa rezerva prokurorët dhe stafin, do t'u jap udhëzime të nevojshme, do t'u krijoj një ambient pune pa ndikime dhe të lire, do të ndajë me ta informacione dhe do t'u ofrojë resurse të nevojshme për punë të suksesshme. Po ashtu do të përgatiten dhe publikohen periodikisht raporte pune dhe aktivitete të prokurorëve dhe stafit. Përveç tjerash në këtë aspekt do të bashkëpunoj ngushtë me KPK dhe ZKPSH-në, institucione dhe agjenci të zabitimit të ligjit, shoqerinë civile si dhe do të shfrytëzoj praktikat me të mira të vendeve të rajonit dhe me gjerë.

Konceptdokumenti nuk duhet të përmbajë më shumë se 10 faqe me shkrim e llojit Book Antiqua, madhësia 12, hapësirë njëshe.

Deklaroj se përmbajtjen e këtij Konceptdokumenti e kam përgatitur vet, dhe jam në dijeni se Konceprdokumenti i Kryeprokurorit të emëruar do të publikohet në ueb faqe.

Nënshkrimi: 

Datë: 03. 11. 2023